VENDIM
Nr.1, datë 25.3.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Kristaq Ngjela	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Spiro Spiro	Anëtar
Agron Lamaj	Anëtar
Artan Hoxha	Anëtar
Nikoleta Kita	Anëtare
Ylvi Myrtja	Anëtar
Valentina Kondili	Anëtare
Vladimir Metani	Anëtar
Vladimir Bineri	Anëtar
Irma Bala	Anëtare
Shpresa Beçaj	Anëtare
Besnik Imeraj	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 25.3.2005 morën në shqyrtim çështjen penale që i përket:

TË PANDEHURVE: EDI BIBA, PAULIN PRENGA,TONIN PJETRI

AKUZA: Kryerja e veprave penale të rrëmbimit të personit, në bashkëpunim, dhe mbajtje e armëve pa leje, parashikuar nga nenet 109, paragrafi i parë, nenet 25 dhe 279, paragrafi i dytë të Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë, me vendimin nr.100, datë 10.11.2003, ka vendosur:

Pushimin e gjykimit të çështjes penale për të pandehurin Edi Biba, për veprën penale të vetëgjyqësisë, të kryer në bashkëpunim, sipas nenit 277 e 25 të Kodit Penal, pasi është amnistuar.

Pushimin e gjykimit të çështjes penale për të pandehurin Tonin Pjetri, për veprën penale të vetëgjyqësisë, të kryer në bashkëpunim, sipas nenit 277 e 25 të Kodit Penal, pasi është amnistuar.

Pushimin e gjykimit të çështjes penale për të pandehurin Paulin Prenga, për veprën penale të vetëgjyqësisë, të kryer në bashkëpunim, sipas nenit 277 e 25 të Kodit Penal, pasi është amnistuar.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Paulin Prenga për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278 paragrafi i dytë i Kodit Penal, dënimin e tij me 5 muaj burgim, dënim i cili është vuajtur.

Deklarimin e pafajshëm të të pandehurve Edi Biba e Tonin Pjetri për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.163, datë 11.3.2004 ka lënë në fuqi vendimin nr.100, datë 10.11.2003 të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Mirditë.

Kundër këtyre vendimeve ka paraqitur rekurs prokurori, i cili kërkon ndryshimin e tyre dhe deklarimin fajtor të tre të pandehurve për veprën e heqjes se paligjshme të lirisë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110, paragrafi i dytë i Kodit Penal dhe dënimin e secilit me 3 vjet burgim, duke parashtruar këto shkaqe:

- Të dyja gjykatat nuk kanë marrë në analizë elementet e veprës penale të heqjes e paligjshme të lirisë dhe ndryshimet që kjo vepër ka me atë të vetëgjyqësisë, si dhe konkurrimin e veprave në rastin konkret.

- Të pandehurit, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, i kanë hequr në mënyrë të paligjshme lirinë të dëmtuarit Besnik Lleshi, duke e marrë, futur me dhunë në makinë, më pas e kanë nxjerrë nga makina dhe kanë ecur rrugës së malit së bashku, dhe e kanë lëshuar vetëm nga frika e policisë. Po të mos ishte ndërhyrja e policisë, të pandehurit nuk kishin për ta lëshuar të dëmtuarin.

-Vetëgjyqësia, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, si vepër, drejtohet kundër pasurisë apo interesave të tjera që i pandehuri mendon se i takon, pa i zgjidhur në rrugë ligjore, por jo kundër

personit. Po qe se gjatë kryerjes së veprës së vetëgjyqësisë ushtrohet dhunë në forma të ndryshme ndaj personit, ku mund të shkaktohen dëmtime trupore, apo hiqet liria, këto veprime konkurrojnë me vetëgjyqësinë, prandaj të pandehurit duhet të përgjigjen për veprën penale të vetëgjyqësisë dhe heqjes së paligjshme të lirisë, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 277 e 25, si dhe 110 paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Në gjykimin e çështjes në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, prokurori ndryshoi përsëri qëndrim lidhur me kualifikimin e veprës penale nga heqje e paligjshme e lirisë dhe vetëgjyqësi, në rrëmbim personi të kryer në bashkëpunim, neni 109 e 25 të Kodit Penal. Ai arsyeton se veprimet e të gjykuarve i përgjigjen plotësisht elementeve të anës objektive të veprës penale të rrëmbimit të personit, që bëhet jo vetëm për të fituar pasuri, por edhe për të realizuar kushte a kërkesa të tjera e çdo qëllim tjetër.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.506/6 Akti, datë 26.1.2005, e ka dërguar çështjen në Kolegjet e Bashkuara për përcaktimin e saktë të praktikës gjyqësore, lidhur me cilësimin juridik të veprës penale dhe të interpretimit gjyqësor të dispozitave të nenit 109, 110 dhe 277 të Kodit Penal.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes **nga gjyqtarët Artan Hoxha dhe Valentina Kondili**, prokurorin Bujar Sheshi, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe deklarimin fajtorë të të gjykuarve për veprën penale të rrëmbimit të personit të kryer në bashkëpunim, neni 109/1 e 25 i Kodit Penal,

mbrojtësin e të gjykuarit Tonin Pjetri, avokatin Viktor Ikonomi, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit,

dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Nga gjykimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mirditë dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, rezultojnë të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

I dëmtuari Besnik Lleshi kishte punuar në Itali me vëllanë e të gjykuarit Tonin Pjetri, Altin Pjetrin, i cili i kishte dhënë 10 milionë lireta që t'ia dërgonte familjes së tij. Njëkohësisht, Altini kishte njoftuar familjarët nëpërmjet telefonit për dërgimin e parave dhe i kishte sqaruar që një pjesë të shumës t'ia jepin të gjykuarit Edi Biba, për shlyerjen e një borxhi.

Duke parë se i dëmtuari nuk po i sillte të hollat, pasi me to kishte blerë një makinë, i gjykuari Tonin Pjetri, së bashku me dy të gjykuarit e tjerë Edi Biba dhe Paulin Prenga, më datë 25.9.2001, kanë shkuar në një lokal në fshatin Fierzë, ku i dëmtuari drekonte me dy shokë të tij, me forcë dhe nën kërcënimin e armës e kanë marrë me vete. Në vijim të veprimeve të tyre, kanë hipur në dy makina, në atë tip "BMW" të vetë të dëmtuarit dhe një tjetër tip "Golf" dhe janë nisur në drejtim të fshatit Pllane, Lezhë. Duke qenë se policia, e lajmëruar nga shokët e të dëmtuarit, është vënë në ndjekje të tyre, në fshatin Pllane ata kanë lënë makinat dhe janë ngjitur një pjesë rruge me këmbë në drejtim të malit. Më pas, duke qenë të ndjekur nga policia, e kanë lënë të lirë dhe pasi kanë hedhur armën dhe janë larguar duke iu fshehur ndjekjes.

Për sa më sipër, të gjykuarit janë akuzuar nga organi i prokurorisë për veprën penale të rrëmbimit të personit të kryer në bashkëpunim, si dhe armëmbajtjes pa leje.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë, duke i pranuar rrethanat e çështjes si më sipër, i ka bërë një cilësim të ri juridik veprës nga rrëmbim i personit në vetëgjyqësisë, me arsyetimin se të tre të gjykuarit nuk e rrëmbyen të dëmtuarin për të realizuar ndonjë përfitim në të holla, por vetëm për të bërë të mundur dhënien prej tij të shumës së të hollave të dërguara nga Italia dhe që u përkisnin atyre. Nga ky fakt që nuk mohohet nga i dëmtuari, rezulton se mungon qëllimi i përfitimit në dëm të një tjetri, që në veprën e rrëmbimit duhet të jetë i pranishëm.

Të njëjtin arsyetim ka bërë edhe Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë.

Organi i prokurorisë në rekurs ka pretenduar se vepra penale e vetëgjyqësisë konkurron me atë të heqjes së paligjshme të lirisë, për faktin së gjatë vetëgjyqësisë është ushtruar dhunë ndaj personit

dhe i është hequr liria, prandaj të gjykuarit duhet të dënohen edhe për këtë vepër.

Ndryshe sa është parashtruar në rekurs, prokurori i seancës në Kolegjin Penal, kërkoi përsëri ndryshimin e kualifikimit të veprës në rrëmbim personi, neni 109/1 dhe 25 i Kodit Penal, duke arsyetuar se veprimet e të gjykuarve i përgjigjen plotësisht elementeve të anës objektive të veprës së rrëmbimit të personit, që bëhet jo vetëm për të fituar pasuri, por edhe për të realizuar kushte a kërkesa të tjera, a çdo qëllim tjetër.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë diskutoi çështjen në fjalë dhe vëren se ka mendime të kundërta lidhur me interpretimin dhe cilësimin ligjor të veprës së kryer nga të gjykuarit, nëse është "rrëmbim personi", "heqje e paligjshme e lirisë", "vetëgjyqësi", apo konkurrim i tyre me njëra-tjetrën.

Për sa më sipër, nisur nga mendimet e kundërta që ekzistojnë ndërmjet gjykatave, organit të prokurorisë dhe në praktikën gjyqësore në tërësi, Kolegji Penal çmoi se kjo çështje duhet të kalojë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara për unifikim të praktikës gjyqësore.

Nisur nga këto fakte dhe rrethana, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se vendimet e të dy gjykatave janë rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit.

Nga analiza dhe interpetimi i dispozitave të Kodit Penal, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se vepra penale e kryer nga të gjykuarit nuk është ajo e rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit parashikuar në nenin 109 të Kodit Penal, por ajo e heqjes se paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësia, parashikuar nga nenet 110 dhe 277 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal. I gjykuari Paulin Prenga ka konsumuar edhe veprën penale të mbajtjes së armës pa leje parashikuar në nenin 279, paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Në arritjen e përfundimeve të saj, në gjykimin e kësaj çështje, Kolegjet çmojnë se analiza e anës subjektive të veprave penale është vendimtare për të bërë kualifikimin e saktë të veprës penale të kryer nga të gjykuarit. Nga vendimet e gjykatave rezulton e pranuar dhe e provuar se qëllimi i veprimeve kriminale të kryera nga të gjykuarit ishte ushtrimi i një të drejte, pa iu drejtuar organeve kompetente apo gjykatës, për të marrë një shumë të hollash që, ndonëse njihej si detyrim kundrejt tyre, i dëmtuari nuk ua kish dhënë dhe e mbante padrejtësisht.

Këto elemente dhe rrethana të anës subjektive, duke u shqyrtuar dhe analizuar së bashku me elemente e rrethana të tjera të anës objektive, gjithashtu bëjnë të mundur dallimin ndërmjet veprave penale të lartpërmendura, si dhe konkurrimin ose jo ndërmjet tyre.

Kolegjet e Bashkuara, për të arritur në përfundimet e saj dhe për qëllime të njehsimit të praktikës gjyqësore, çmojnë të domosdoshme analizën dhe interpretimin e elementeve të figurës së të tri veprave penale, atë të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit, neni 109, heqjen e paligjshme të lirisë, neni 110 dhe vetëgjyqësinë, neni 277.

Heqja e paligjshme e lirisë, neni 110 i Kodit Penal, parashikon mbrojtjen e përgjithshme të lirisë së personit kundrejt çdo lloj privimi të saj, dhunimit dhe nënshtrimit të detyrueshëm fizik nga cilido, veprime këto që nuk janë të autorizuara apo të lejuara nga ligji.

Motivi, veprimet a mosveprimet e autorit të kësaj vepre penale nuk janë të një natyre të përcaktuar shprehimisht prej saj. Heqja e paligjshme e lirisë mund të realizohet nëpërmjet veprimeve (aktive) duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në to: ushtrimi i dhunës mbi personin duke e rrëmbyer, mbajtur peng, e shoqëruar me bllokimin, prangosjen etj. ose në forma të tilla si injektimi i substancave narkotike që pamundësojnë reagimin dhe sjelljen normale të viktimës, dhunës psiqike dhe kanosjeve nëpërmjet përdorimit dhe drejtimit të armëve ndaj viktimës.

Nuk përjashtohen në heqjen e paligjshme të lirisë edhe përdorimi i formave të mashtrimit dhe gënjeshtrës me synim dhunimin e lirisë apo vetëprivimin e viktimës nga liria personale për gjendjen e tij në situata të një sëmundjeje të pashërueshme, të rëndë, ngjitëse etj., në situata të një rreziku (që në fakt nuk ekziston), vendosjen në gjendje sugjestionimi a supersticioziteti etj.

Kjo vepër mund të kryhet edhe nëpërmjet mosveprimeve, kur nëpërmjet tyre mund të shkaktohet dhe realizohet heqja e paligjshme e lirisë. Në këto raste zbatimi i dispozitës shtrihet mbi ata persona (autorë) që kanë në ngarkim apo si detyrë të përcaktueshme mbrojtjen dhe garantimin e lirisë individuale të viktimës.

Heqja e paligjshme e lirisë (neni 110 i Kodit Penal), nga pikëpamja e anës subjektive realizohet për qëllime dhe motive që nuk janë nga ato të përfshira në nenin 109 të Kodit Penal, pavarësisht nëse janë a pretendohen të jenë të drejta a të ligjshme dhe pavarësisht nëse ato janë me natyrë pasurore, materiale ose të një natyre a marrëdhënie tjetër, që nuk kualifikohen si të tilla.

Nga pikëpamja e anës objektive heqja e paligjshme e lirisë (nënkuptohet rrëmbimi dhe mbajtja peng), pavarësisht nga mënyra e kryerjes, do të kuptohet si privim i lirisë së lëvizjes së personit në hapësirë sipas rrethanave dhe çmimit subjektiv të tij. Paprekshmëria e personit, liria e lëvizjes personale, për të mos u penguar a mbajtur fizikisht, por edhe psikologjikisht i lidhur nga një rrethanë e paligjshme dhe e dhunshme, është një e drejtë universale, natyrale, një nga liritë themelore të garantuar nga Kushtetuta.

Përsa i përket përcaktimit të heqjes së paligjshme të lirisë, ardhjes së pasojës dhe shkallës së tyre, është e rëndësishme të vërtetohet një kohëzgjatje e matshme dhe e mjaftueshme e privimit të lirisë, e cila jo domosdoshmërisht duhet të jetë e gjatë. Nuk përbën heqje të paligjshme të lirisë vërtetimi i kësaj gjendje objektive në një çast të caktuar ose kalimtar, me motivim dhe në kryerje e sipër të një veprimi të caktuar.

Gjithashtu, në kualifikimin e veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë, nuk ndikon shkalla relative apo absolute e heqjes së lirisë dhe as natyra e pengesave, bllokimit e përdorimit të mënyrave të tjera që bëjnë relativisht a plotësisht të përjashtuar ose të pamundur kapërcimin e tyre nga viktima apo mundësinë e vetëlirimit të tij.

Vepra penale e heqjes së paligjshme të lirisë, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe shpjegimet e parashtruara më sipër, quhet e kryer që në çastin kur vërtetohet koha dhe vendi i realizimit të privimit dhe dhunimit të lirisë së personit.

Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit, neni 109 i Kodit Penal, synon të mbrojë në rradhë të pare lirinë e personit. Interpretimi dhe zbatimi korrekt i kësaj dispozite kërkon të mbahen parasysh ndërmjet të tjerave, dy elemente thelbësore:

a) përfitimi i padrejtë e realizimi i interesave të tjera të paligjshme në kuptim të rasteve të parashikuara nga dispozita dhe

b) lirimi i viktimës përkundrejt marrjes së këtij përfitimi.

Edhe pse është e vendosur në seksionin VII "veprat penale kundër lirisë së personit", neni 109 ka për objekt jo thjesht mbrojtjen e lirisë personale, por edhe paprekshmërinë dhe mbrojtjen e pasurisë. Veprimet dhe motivet e autorëve të veprës penale e kthejnë viktimën në një instrument, "send" të cenuar si qenie njerëzore dhe në interesat e tij pasurore e jopasurore. Ekziston një lidhje e ngushtë midis qëllimit të veprës, përfitimit dhe lirimit të personit për këtë shkak. Ai shkëmbehet, pra lihet i lirë, vetëm përkundrejt realizimit të përfitimit të pasurisë, përfitimeve dhe qëllimeve të tjera të parashikuara në dispozitë.

Në aspektin subjektiv, ekzistenca ose jo e një marrëveshjeje apo marrëdhënie të mëparshme mes viktimës dhe autorit të veprës penale mund të përbëjnë edhe shkakun për kryerjen e veprës penale të rrëmbimit a mbajtjes peng të personit, por ky aspekt duhet të konsiderohet i përfshirë në qëllimin final të realizimit të një përfitimi të padrejtë e të paligjshëm, si një çmim, kompensim për lirimin e viktimës apo edhe për të lehtësuar gjendjen e të dëmtuarit që i është hequr liria në mënyrë të paligjshme.

Neni 109 është i qartë në këtë drejtim, sepse ligjvënësi ka përcaktuar vendimtar në kuptim të anës subjektive realizimin e qëllimit "*... për të fituar pasuri ose çdo lloj përftimit tjetër ....*" dhe jo shkakun e saj. Pra qëllimi i përfitimit dhe lirimi i viktimës përkundrejt realizimit të këtij qëllimi, përbëjnë në mënyrë të njëkohshme elemente thelbësore të kësaj vepre penale.

Neni 109 i Kodit Penal (ashtu sikurse edhe neni 110 i tij), duhet të konsiderohet i kryer me heqjen e paligjshme të lirisë, rrëmbimin a mbajtjen peng të viktimës, pavarësisht nëse autori ka arritur ose jo të realizojë përfitimet dhe qëllimet e parashikuara në vepër dhe përkundrejt të cilave ai do të lirojë viktimën.

Nëse gjatë gjykimit vërtetohet natyra e padrejtë e përfitimit si motiv për rrëmbimin a mbajtjen peng, jemi përpara rastit kur një person privohet nga liria, pra, rrëmbehet a mbahet peng dhe i kërkohet një përfitim i padrejtë përkundrejt lirimit të tij. Në këtë rast është evidente lidhja e ngushtë ndërmjet veprimeve të kryera, qëllimit të përfitimit të padrejtë dhe kërkesës për të dhënë përfitimin përkundrejt lirimit të viktimës. Prandaj, në këto raste Kolegjet çmojnë se figura e veprës penale që duhet të gjejë zbatim është ajo e rrëmbimit ose marrjes peng të personit, neni 109 i Kodit Penal.

Po ashtu, fakti që ka ekzistuar një kërkim a marrëdhënie e mëparshme qoftë edhe e paligjshme ndërmjet autorit të veprës dhe viktimës, shërben vetëm për të individualizuar llojin dhe masën e dënimit, por jo aspektet e tjera të anës subjektive që kërkon neni 109 i Kodit Penal, realizimi i një përfitimi të padrejtë përkundrejt lirimit të viktimës.

Një nga elementet specifike që është dalluese dhe përcaktuese në kualifikimin e veprës, sipas nenit 109 apo nenit 110 të Kodit Penal, lidhet me anën subjektive të tyre, pikërisht me qëllimin, motivin e autorit të veprës penale dhe që ka të bëjë me realizimin e një përfitimi pasuror, përfitimeve a qëllimeve të tjera (të ngjashme). Kjo situatë del nga vetë kuptimi në tërësi i nenit 109 të Kodit Penal ku përfitimet dhe qëllimet duhet të jenë të padrejta, të përbëjnë një interes të paligjshëm, për vete ose për të tjerët, përkundrejt lirimit të viktimës. Motivi dhe qëllimi i veprës sipas nenit 109 të Kodit Penal, lidhet me realizimin në mënyrë të padrejtë të një përfitimi pasuror, të një qëllimi tjetër të paligjshëm a në rrugë të paligjshme, përfshirë edhe qëllime të tjera të ngjashme me ato të përmendura shprehimisht në këtë dispozitë.

Ndërkohë, heqja e paligjshme e lirisë nuk i ka të përcaktuara motivet në kuptim të anës subjektive, gjë që do të thotë se ato janë të tilla që nuk përfshihen në nenin 109 të Kodit Penal ose në vepra të tjera penale.

Duke analizuar përmbajtjen e nenit 109 të Kodit Penal rezultojnë dy çështje thelbësore për anën objektive të kësaj vepre. Kështu, sjellja dhe veprimet e autorit sipas nenit 109 të Kodit Penal janë "rrëmbimi ose mbajtja peng e personit", që në vetvete nuk janë gjë tjetër veçse veprime që kanë kuptim të njëjtë ose sjellin si pasojë heqjen e paligjshme të lirisë së viktimës. Nga ana objektive, kjo vepër penale nuk ka dallim substancial me atë të rrëmbimit të personit, pavarësisht se dy dispozitat përmbajnë fjalë e terma të ndryshme në pikëpamjen gjuhësore: "rrëmbim ose mbajtja peng" dhe "heqje e paligjshme e lirisë". Edhe në rastin e nenit 110, nga pikëpamja e anës objektive, është e nënkuptuar se heqja e paligjshme e lirisë e përmban në vetvete ushtrimin e dhunës, kryerjen e veprimeve të tilla që çojnë në heqjen e lirisë dhe pamundësinë e personit për të "lëvizur" në liri. Këto veprime jo vetëm nuk përjashtojnë, por përfshijnë si rastet e mbajtjes peng e rrëmbimit të personit, ashtu edhe forma të tjera të privimit të lirisë pa ushtrim dhune fizike të përmendura më sipër në interpretimin e nenit 110 të Kodit Penal.

Në vijim të këtij interpretimi mund të bëhet edhe dallimi ndërmjet nenit 109 dhe nenit 109/b të Kodit Penal. Në rastin e nenit 109/b, ligjvënësi ka përcaktuar qartë se realizimi i anës subjektive, kryerja a moskryerja nga personi i një veprimi të caktuar, përfitimi ndaj tij ose në dëm të tij, padrejtësisht, i pasurisë ose çdo përftimi tjetër, për vete ose të tretët, nga pikëpamje të anës objektive realizohet nëpërmjet kanosjes dhe formave të tjera të dhunës fizike, por që nuk sjellin si pasojë privimin, heqjen e paligjshme të lirisë personale të personit (viktimës). Ndërkohë që, në nenin 109, realizimin e anës subjektive ligjvënësi e lidh shprehimisht me ushtrimin e formave të veçanta të dhunës: rrëmbimit ose mbajtjes peng me pasojë privimin, heqjen e paligjshme të lirisë personale të viktimës.

Si në rastin e nenit 109, ashtu edhe për nenin 110 (por edhe neni 109/b) të Kodit Penal, vërtetimi i realizimit të qëllimit dhe motivit përkatës, ardhja e pasojave të parashikuara prej tyre, nuk përbëjnë elemente përcaktuese, për ekzistencën ose jo të veprës penale, por ajo quhet e kryer që nga momenti i heqjes së lirisë së personit.

Vetëgjyqësia, neni 277 i Kodit Penal parashikon ushtrimin e një të drejte nga personi që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri, pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror.

Kjo dispozitë synon jo vetëm të mbrojë ushtrimin e autoritetit shtetëror, por edhe që të parandalojë e ndëshkojë sjelljet dhe veprimet shoqërisht të rrezikshme me të cilat autori i atribuon vetvetes të drejtën për të realizuar një të drejtë a zgjidhur një mosmarrëveshje që ka me të dëmtuarin, duke shmangur rrugën e parashikuar nga ligji për t'iu drejtuar organit kompetent shtetëror. Në këtë kuptim, autori i veprës vepron duke shkelur dhe "zëvendësuar" veprimin e organit kompetent, i cili, nga ana e tij, ka juridiksionin, kompetencën dhe detyrën që të zgjidhë konfliktin mes palëve sipas ligjit, me objektivitet dhe paanshmëri. Ky veprim i autorit, në vetvete është i paligjshëm dhe arbitrar.

Nuk do të jemi përpara rastit të vetëgjyqësisë, ushtrimit arbitrar, të paligjshëm të së drejtës, nëse autori vepron, mbi sendin me synimin për të mbrojtur posedimin e ligjshëm dhe aktual të tij, të cenuar apo shqetësuar nga veprimi i paligjshëm i një personi të tretë, përderisa nuk jemi përpara detyrimit ligjor ose mundësisë për t'iu drejtuar organit kompetent shtetëror a gjykatës.

Pavarësisht se nuk përmendet shprehimisht në dispozitë, nga pikëpamja e anës objektive vetëgjyqeësia kryhet nga autori nëpërmjet ushtrimit arbitrar të së drejtës, me forma të ndryshme të dhunës fizike a psikike (kanosjes, etj.), drejtpërdrejt mbi personin ose indirekt, duke vepruar mbi sendin a interesin mbi të cilin ekziston apo pretendohet se ekziston e drejta (e ligjshme) e autorit të veprës. Objekti mbi të cilin vepron autori jo domosdoshmërisht është ai për të cilin ushtron

vetëgjyqësinë, mbi të cilin ai ka të drejtën a interesin e ligjshëm ose të pretenduar se i përket autorit.

Gjithashtu, është e rëndësishme që të ekzistojë mjeti, rruga ligjore dhe mundësia për autorin që të realizojë të drejtën e tij duke iu drejtuar organit kompetent shtetëror, e në veçanti gjykatës.

Duke analizuar sa më sipër rrethanat e faktit dhe elementet e figures së veprave penale të vëna në shqyrtim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimet e mëposhtme unifikuese:

Nëse mungon përfitimi i padrejtë, pra synohet a pretendohet të realizohet një interes i ligjshëm, përkundrejt ndërprerjes dhe dhunimit të lirisë (rrëmbimit a marrjes peng të viktimës), atëherë jemi përpara veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë, neni 110 i Kodit Penal, e cila konkurron me veprën penale të vetëgjyqësisë, neni 277 i Kodit Penal. Natyra e drejtë apo e padrejtë e përfitimit a interesit duhet të çmohet jo mbi bazën e vlerësimit personal të autorit të veprës, por nisur nga vlerësimi objektiv i tërësisë së rrethanave që rezultojnë në gjykimin e çështjes.

Nga pikëpamja e anës subjektive, vetëgjyqësia dallon edhe nga shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë, neni 109/b i Kodit Penal në rastin e nenit 109/b, autori synon një përfitim të padrejtë, është në dijeni dhe parashikon se ajo që synon të përfitojë apo pretendon të fitojë është e paligjshme dhe e padrejtë. Ndërsa autori i veprës në vetëgjyqësi synon të realizojë një të drejtë që i përket apo sipas rrethanave, pretendon se i përket atij dhe është i bindur sipas këtyre rrethanave (edhe pse mund të mos ketë të drejtë) se ajo që pretendon se i përket atij është e drejtë.

Dispozitat e neneve 109, 110 dhe 277 të Kodit Penal, parashikojnë mbrojtjen e marrëdhënieve shoqërore që cenojnë personin dhe pasurinë. Ndërkohë, në rastin e vetëgjyqësisë, mbrohen marrëdhëniet që lidhen me rendin dhe sigurinë publike. Është e kuptueshme se ligjvënësi bën një rregullim specifik, por edhe të ndërsjellë të marrëdhënieve të mbrojtura nëpërmjet këtyre dispozitave penale.

Në rastet e neneve 109 dhe 110, personi është cenuar në të drejtën e tij për të gëzuar lirinë personale. Rrëmbimi ose mbajtja peng janë forma të ushtrimit të dhunës fizike të shoqëruara ose jo me elemente të tjera të natyrës së dhunës psikike dhe që synojnë e sjellin si pasojë, një rezultat të vetëm: heqjen e paligjshme të lirisë personale. Për këto arsye, pavarësisht nga dallimi përsa i përket anës subjektive, këto dy vepra penale nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën.

Ndryshe nga nenet 109 dhe 109/b të Kodit Penal, në kuptim të anës subjektive, në nenin 277 të këtij Kodi, motivi dhe qëllimi lidhen me pretendimin për të mbrojtur një qëllim të drejtë a interes të ligjshëm. Në këtë rast, veprimet e njëjta a të ngjashme në kuptim të anës objektive nuk ndikojnë në përfundimin që neni 109 (por edhe neni 109/b) nuk konkurron me nenin 277 të Kodit Penal.

Në nenin 109, vepra kryhet nëpërmjet rrëmbimit a mbajtjes peng (që janë në vetvete elemente të heqjes së paligjshme të lirisë personale), ndërsa në nenin 109/b parashikohen elementet e tjera të dhunës psikike a fizike, që nuk janë ato të përmbajtura në nenin 109 të Kodit Penal. Në këtë kuptim, neni 109 nuk konkurron me nenin 109/b.

Nuk konkurrojnë me njëri-tjetrin as neni 109/b dhe neni 110 i Kodit Penal, për arsye se në rastin e parë kemi të bëjmë me veprime a mosveprime të autorit të veprës me motiv sigurimin e përfitimeve të padrejta, por pa i hequr lirinë viktimës së tij. Ndërsa në rastin e nenit 110, edhe pse motivi i kryerjes së veprës është i pakonkretizuar (raste që nuk përfshihen në nenin 109), thelbësor është kryerja e saj duke i hequr në mënyrë të paligjshme lirinë viktimës.

Ndërkohë që konkurrojnë me njëri-tjetrin neni 110 me nenin 277, për arsyen thelbësore që vetëgjyqësia, neni 277, konsumohet për motive të mbrojtjes së një të drejte a interesi të ligjshëm, pa iu drejtuar organit kompetent. Pavarësisht nga e drejta dhe interesi i ligjshëm që mbrohet, veprimet e autorit, të çdo forme qofshin, drejtohen ndaj personit ose sendeve, në mënyrë arbitrare. Nëse këto veprime bëhen duke u shoqëruar me format e privimit të lirisë së personit, atëherë autori ka konsumuar edhe një vepër tjetër penale, atë të heqjes së paligjshme të lirisë, neni 110 i Kodit Penal.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, rezulton se të gjykuarit kanë konsumuar veprat penale të heqjes së paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësisë, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, parashikuar nga nenet 110/2 dhe 277 e 25 të Kodit Penal.

Gjykata, në analizë të rrethanave të faktit, personalitetit të secilit të gjykuar dhe rrezikshmërisë së tyre ashtu sikurse kanë pranuar gjykatat e tjera në arritjen e përfundimeve të tyre, çmon se të gjykuarit Edi Biba dhe Tonin Pjetri duhet të dënohen për veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë me nga 3 vjet burgim, ndërsa i gjykuari Paulin Prenga me 3 vjet e 6

muaj burgim, ndërsa për pjesët e tjera vendimi i gjykatës se apelit duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 141/2 të Kushtetutës, të neneve 14/c dhe 17/b të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSËN:

Lënien në fuqi të vendimit nr.163, datë 11.3.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lidhur me deklarimin fajtor të të gjykuarve për veprën penale të vetëgjyqësisë dhe për të gjykuarin Paulin Prenga edhe për mbajtje arme pa leje.

Ndryshimin e vendimit përsa i përket cilësimit juridik të veprës penale, duke i deklaruar të tre të gjykuarit fajtorë për veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë sipas nenit 110/2 të Kodit Penal.

Dënimin e të gjykuarve Edi Biba dhe Tonin Pjetri me tre vjet burgim dhe të gjykuarin Paulin Prenga me 3 vjet e gjashtë muaj burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimit, i gjykuari Paulin Prenga dënohet përfundimisht me 3 vjet e gjashtë muaj burgim.

Ky vendim për njehsimin e praktikës gjyqësore dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 25.3.2005

MENDIMI I PAKICËS

Në vendimin unifikues nr.1, datë 25.3.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Pakica nuk është dakord me vendimin e shumicës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si përsa i përket zgjidhjes që u dha prej saj në këtë çështje (dispozitivit), ashtu edhe pjesës arsyetuese të tij, rrjedhojë e së cilës është kjo zgjidhje.

Nga aktet e dosjes rezulton se ditën e ngjarjes, gjatë kohës që i dëmtuari Besnik Lleshi ishtë duke drekuar me dy shokë të tij në një lokal në fshatin Fierzë (Kurbin), tre të gjykuarit, duke qenë të armatosur me lloje të ndryshme armësh luftarake, (pistoletë, automatik dhe pushkë të gjatë), kanë shkuar atje, me automjetin e tyre dhe, pa bërë ndonjë bisedë të mëparshme me këtë të dëmtuar, duke i drejtuar armën, e detyruan që t'i shoqëronte në automjetin e tij që ndodhej i ndaluar në rrugë, para lokalit. Me çelësat që i morën të dëmtuarit, nën kërcënimin e armës, hapën derën e automjetit të këtij të fundit dhe, pasi, po me kërcënimin e armëve, e hipën në sediljen e përparme të pasagjerit, mbrapa së cilës, me armë të drejtuar mbrapa kokës së tij, u ul i gjykuari Pjetri, i gjykuari Biba nisi automjetin në drejtim të qytetit të Lezhës, kurse i gjykuari i tretë, Prenga, i ndiqte nga mbrapa me automjetin me të cilin ata kishin shkuar në vendin e fillimit të kësaj ngjarjeje.

Pa arritur ende në fshatin Pllan, të gjykuarit e urdhëruan të dëmtuarin, që t'u jepte 10 milionë lireta italiane, (sipas të dëmtuarit për t'ia dhënë një personi me emrin Altin Nikolli, të cilin ata e quanin "Kapo", kurse, sipas gjykatave, për llogari të një borxhi). Ndërkohë, nën kërcënimin e armëve, i grabitën 500 mijë lireta që i kishte me vete.

Gjykatat, përfshirë edhe shumicën e Kolegjeve të Bashkuara, pranojnë se, duke qenë që policia, e lajmëruar nga shokët e të dëmtuarit, ishte vënë në ndjekje, për t'i shpëtuar kapjes, të gjykuarit lanë automjetet në një rrugë dytësore dhe për t'u shmangur, filluan të ngjiten në një rrugë malore fshati, ku, duke qenë vazhdimisht të ndjekur nga policia, u detyruan ta lënë të lirë të dëmtuarin dhe vetë u larguan me shpejtësi, për t'u fshehur, duke u rënë, madje, dhe njëra nga armët, në vendin e ngjarjes.

Duke e reduktuar ngjarjen vetëm në shpjegimet e të gjykuarve, sipas të cilave veprimet, si më sipër, i kishin kryer për të marrë nga i dëmtuari një sasi të hollash që, njërit prej tyre, ia kishte dërguar, nëpërmjet tij, vëllai nga Italia, shumica i cilësoi ato si vetëgjyqësi, heqje të paligjshme të lirisë dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake, vepra penale këto të parashikuara nga nenet 277, 110/II dhe 278/II të Kodit Penal. Prokuroria i kishte akuzuar ata për krimet e rrëmbimit të personit dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga neni 109 i Kodit Penal, në lidhje me nenin 25 të tij dhe

neni 278/II i këtij Kodi, qëndrim që u mbajt edhe nga përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë shqyrtimit të çështjes, si në Kolegjin Penal, ashtu edhe në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Pakica është e mendimit se kërkesa e prokurorit është e drejtë dhe duhej të ishte pranuar.

Në këtë përfundim pakica, ndryshe nga mënyra e copëzuar që përdor shumica për të bërë interpretimin e dispozitave të neneve 109, 110/II dhe 277 të Kodit Penal, në të cilat janë parashikuar, përkatësisht figurat e veprave penale të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit, të heqjes së paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësisë arriti, duke ballafaquar, përmbajtjen e secilës prej tyre, me njëra-tjetrën (interpretimi sistematik).

Pakica niset, së pari, nga përmbajtja e dispozitës së nenit 109 të Kodit Penal, në të cilën parashikohet figura e krimit të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit, dispozitë në të cilën, në mënyrë qartësisht të shprehur, përshkruhen format dhe mënyrat nëpërmjet të cilave kryhet kjo vepër penale, nga ana objektive.

Ligjvënësi në këtë dispozitë ka përcaktuar dy format nëpërmjet të cilave kryhet kjo figurë krimi, nga ana objektive, që janë: a) rrëmbimi i personit dhe b) mbajtja peng e tij. Mjafton ekzistenca e njërës prej tyre për të pasur të plotësuar anën objektive të saj. Dhe, për të dalluar figurën e krimit të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit (neni 109 i Kodit Penal) nga figura e veprave penale të heqjes së paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësisë (nenet 110 dhe 277 të Kodit Penal), i ka kushtëzuar, si rrëmbimin, ashtu edhe mbajtjen peng, me anën subjektive të autorit të tyre (rrëmbimit apo mbajtjes peng i personit). Kushtëzimi konsiston në faktin që, jo çdo lloj rrëmbimi apo mbajtje peng i personit (pavarësisht nga mënyra dhe mjetet e përdorura), do të përbëjë rrëmbim apo mbajtje peng, si element të anës objektive të figurës së krimit, të parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal.

Sipas kësaj dispozite, (nenit 109 të Kodit Penal), këto veprime (rrëmbimi dhe mbajtja peng e personit) do të përbëjnë anën objektive të figurës së krimit që parashikohet prej saj, me kushtin dhe vetëm atëherë kur kryhen për të arritur një nga qëllimet e renditura shprehimisht në përmbajtjen e vetë kësaj dispozite. Pikërisht këto qëllime përbëjnë edhe qëllimin e posaçëm që është elementi karakteristik, i cili, përveç dashjes direkte përbën anën sukjektive të figurës së krimit të parashikuar në nenin 109 të Kodit Penal. Ky është edhe elementi bazë që dallon këtë figurë krimi nga figura e veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë (neni 110 i Kodit Penal). Po të niseshim vetëm nga ana objektive, vështirë se do bëhej i mundur dallimi midis tyre, pasi si rrëmbimi, (në kuptimin e përgjithshëm të kësaj fjale), ashtu edhe mbajtja peng e personit, janë dy nga mënyrat që ndeshen më shpesh në praktikën e gjykatave, nëpërmjet të cilave, realizohet vepra penale e heqjes së paligjshme të lirisë. Kjo e fundit mund të kryhet nisur nga motive dhe për të arritur qëllime nga më të ndryshmet, përjashtuar qëllimet dhe motivet, të cilat ligjvënësi i ka përmendur, në mënyrë alternative, në përmbajtjen e dispozitës së nenit 109 të Kodit Penal.

Si qëllime të kësaj natyre, ligjvënësi ka renditur:

a) për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër;

b) për të përgatitur krijimin e kushteve lehtësuese për kryerjen e një krimi;

c) për të ndihmuar fshehjen ose largimin e autorëve ose bashkëpunëtorëve në kryerjen e një krimi;

ç) për t'iu shmangur dënimit;

d) për të detyruar realizimin e kërkesave a kushteve të caktuara;

dh) për qëllime politike dhe;

e) për çdo qëllim tjetër.

Këtej arrihet lehtë në përfundimin se edhe ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk i njihet nga tjetri, pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror, (që përbën thelbin e figurës së kundërvajtjes penale të vetëgjyqësisë, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal), kur nuk shoqërohet me veprime që përbëjnë rrëmbim apo mbajtje peng të personit, përbën figurën e kundërvajtjes penale të vetëgjyqësisë. Kurse në rastet kur ushtrimi i kësaj të drejte (që i përket ose që kujton se i përket) shoqërohet me veprime të subjektit, të cilat përbëjnë ose rrëmbim, ose mbajtje peng të personit nga i cili kërkohej realizimi i një të drejte të tillë, vepra cilësohet jo më si vetëgjyqësi (neni 277 i Kodit Penal), por si rrëmbim apo mbajtje peng e personit. Ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri, pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror, në këtë rast, përbën një nga format e konkretizimit të qëllimeve - element i anës subjektive të figurës së krimit të parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal. Me këtë duhet kuptuar që vetë figura e kundërvajtjes penale të vetëgjyqësisë, në këtë rast, përbën anën subjektive të figurës së

krimit të rrëmbimit apo mbajtjes peng të personit-qëllimin e saj. Për rrjedhojë, e para, në këtë rast, thithet nga figura e krimit të rrëmbimit apo mbajtjes peng të personit.

Pakica është e mendimit që, sa u vunë në dukje në këto dy paragrafë, duhej të përbënin edhe një nga përcaktimet unifikuese (sentencat) e këtij vendimi, përcaktime që, për hir të së vërtetës, duhet thënë që, në mos i mungojnë, nuk mund të dallohen qartë midis rreshtave të vendimit të shumicës së Kolegjeve të Bashkuara.

Përcaktimin e dytë unifikues, sipas pakicës, duhej ta përbënte përfundimi, sipas të cilit edhe pse rrëmbimi apo mbajtja peng e personit, në rrethana të zakonshme, janë nga ato veprime që, zakonisht, përbëjnë anën objektive të figurës së veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë, parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal, kur kryhen për realizimin e ndonjërit prej qëllimeve që përmenden në dispozitën e nenit 109 të këtij Kodi, duhet të cilësohen si rrëmbim apo mbajtje peng të personit, figurë krimi kjo që parashikohet, pikërisht nga kjo dispozitë.

Kështu që, ndërsa në rastin e parë, veprimet e vetëgjyqësisë përbënin anën subjektive të figurës së krimit të rrëmbimit apo mbajtjes peng të të dëmtuarit Besnik Lleshi, në rastin e dytë, veprimet që konsistonin në heqjen e paligjshme të lirisë së tij, përbëjnë anën objektive të kësaj figure krimi (nenit 109 të Kodit Penal).

Pakica është e mendimit se nuk mund të ketë konkurrim as midis figurës së veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë (kur veprimet drejtohen ndaj të njëjtëve persona) dhe figurës së krimit të rrëmbimit apo mbajtjes peng; as midis kësaj të fundit dhe figurës së kundërvajtjes penale të vetëgjyqësisë (kur si në rrëmbimin apo mbajtjen peng, ashtu edhe nga vetëgjyqësia dëmtohen të njëjtët persona). Për rrjedhojë, duke qenë se në të drejtën penale vepron parimi që, në këto raste, vepra më e lehtë thithet nga ajo më e rënda, Kolegjet e Bashkuara duhej të prishnin vendimet e dy gjykatave dhe t'i deklaronin fajtorë të gjykuarit për krimin e parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal, në lidhje me nenin 25 të tij.

Përsa i përket krimit të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të tre të gjykuarit duhej të ishin deklaruar fajtorë.

Gjyqtarë:Spiro Spiro, Perikli Zaharia, Valentina Kondili, Vladimir Bineri, Besnik Imeraj, Irma Bala